

**KONTRIBUTI I FAMILJES DERALLA PËR ÇËSHTJEN  
KOMBËTARE SHQIPTARE**  
**Melsi LABI**

**UDK: 323.1(=18):929.521,Дерала**

**Abstrakt**

Në kumtesën time do të trajtoj kontributin e pinjollëve të familjes Deralla për çështjen kombëtare shqiptare. Familja Deralla i ka dhënë kombit figura të shquara, duke filluar me Hasan Derallën, Mehmet Pashë Derallën, Gajurin, Hysenin dhe Halimin. Të gjithë këta që përmenda më sipër, ndonëse kanë sakrifikuar për kombin shqiptar, si për ironi të fatit janë lënë në harresë të plotë. Pinjollët e familjes Deralla kanë lënë gjurmë në ngjarjet më madhore të kombit shqiptar, prandaj duhen vlerësuar ashtu siç e meritojnë, duke u ngritur në piedestalin e patriotizmit dhe të atdhedashurisë.

Pluhuri i harresës u shkund disi me botimin e monografisë rreth jetës dhe aktivitetit të patriotit të madh Mehmet Pashë Deralla. Mbesa e tij, Valdete Deralla ka mundur të grumbullojë dokumente rreth jetës dhe aktivitetit të tij dhe me ndihmën e ushtarakut Vangjel Kasapi, në vitin 1995 u mundësua botimi i monografisë. Gjithashtu, në filmin “Nëntori i Dytë”, i cili është realizuar në vitet e sistemit komunist, figura e Mehmet Pashë Derallës është anashkaluar, ndonëse në të vetmen foto që kemi nga kremtimet e përvjetorit të parë të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, ai qëndronte në ballkon në krah të Ismail Bej Vlorës. Mehmet Pashë Deralla ka hyrë në histori si ministri i parë i Luftës së Shtetit Shqiptar. Për nder të tij, 4 Dhjetori është caktuar Festa e Kombëtare e Forcave të Armatosura Shqiptare.

Sigurisht që ky është vlerësimi më i pakët për njeriun që sakrifikoi kaq shumë për çështjen kombëtare shqiptare. Sot e kësaj dite, ai që flaku tej medaljet e sulltanit dhe përqafoi idetë e shqiptarizmit, është pa varr.

Eshtrat e patriotit të madh Mehmet Pashë Deralla meritojnë respekt dhe dashuri.

**Fjalë kyçe:** patriotizmi e atdhedashuria, sakrifica, pinjollët e familjes Deralla.

Pararendës dhe frymëzues i familjes Deralla ka qenë Hasan Deralla, i cili në vitin 1878 ka marrë pjesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Ndërmjet 54 përfaqësuesve, Hasan Deralla ka nënshkruar aktet e Lidhjes dhe Statutin. Hasan Deralla ka qenë një ndër ata që nënshkruan Memorandumin për Pavarësinë e Shqipërisë. Ky memorandum iu dërgua fuqive të mëdha. Por, patrioti dhe atdhetari, Hasan Deralla, nuk u mjaftua me kaq, ai vuri gjithë pasurinë e tij në shërbim të çështjes kombëtare shqiptare.

Gjithashtu, biri i tij, Mehmet Pashë Deralla u vu në krye të Ushtrisë Vullnetare të Lidhjes. Ai u caktua këshilltar për çështjet ushtarake i Sulejman Vokshit, që në atë kohë kishte postin e ministrit të Luftës të Lidhjes së Prizrenit. Në vijim, Mehmet Pashë Deralla ka kontribuar në Kuvendin e Pejës, i cili u mbajt prej datave 23-29 janar të vitit 1899. Kuvendi i Pejës u mbledh nën drejtimin e patriotit të madh, Haxhi Zeka. Ndër 450 delegatët e kuvendit, spikati Mehmet Pashë Deralla, i cili u bë krahu i djathtë i Haxhi Zekës, në organizimin e kryengritjeve popullore anti-osmane në trevat kosovare. Kuvendi i Pejës u shtyp pa i përmbushur objektivat e tij dhe Mehmet Pashë Deralla u kap nga forcat otomane dhe u internua në Bagdad të Irakut.

Gjatë viteve të qëndrimit në Bagdad, ai u martua me vajzën e një ushtaraku turk dhe nga martesja lindi Gajur Deralla. Në atë kohë, ministri i Jashtëm i Austro-Hungarisë, konti Leopold Berthold ka deklaruar: “I internuari politik Mehmet Pashë Deralla është një burrë me kulturë të gjerë dhe me ndjenja të pastra atdhetare”. Pas dështimit të lëvizjes xhonturke, në vitin 1908, Mehmet Pashë Deralla përfitoi nga amnistia e përgjithshme dhe u kthye në vendlindje. Ndalesën e parë e bëri në portin e Selanikut, ku e pritën me të shtëna artilerie, ashtu siç

priteshin gjeneralët. Nga Selaniku udhëtoi drejt Shkupit, ku e prisnin qindra luftëtarë shqiptarë me plisa të bardhë.

Gjatë viteve 1910-1912, së bashku me të birin Halim Derallën, kanë qenë luftëtarë në kryengritjet shqiptare në Kosovë, përkrah me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Isa Boletinin dhe Idriz Seferin. Mehmet Pashë Deralla, me mbështetjen e luftëtarëve Elez Isufi dhe Ramadan Zaskoci luftoi heroikisht në betejat e Rozhajës, Kumanovës, Drinit, Gjakovës etj., ku ushtria serbe pësoi dëme të shumta.

Në vitin 1912, Mehmet Pashë Deralla (1843-1918), me propozimin e Isa Boletinit, më 4 dhjetor 1912, Mehmet Pashë Deralla u zgjodh ministër i Luftës në Qeverinë e Përkohshme, duke fituar 42 vota dhe duke u radhitur i treti pas Luigj Gurakuqit me 54 vota dhe Myfit Bej Gjirokastrës (Libohovës) me 52 vota. Ministri i Luftës, Mehmet Pashë Deralla, duke bashkëpunuar me kryetarin e Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemalin, krijoi lidhje të ngushta me patriotët e shquar si Bajram Curri, Idriz Seferi dhe Haxhi Zeka, duke organizuar ushtrinë kombëtare shqiptare.

Ndonëse ishte në moshën 69-vjeçare, Mehmet Pashë Deralla nisi detyrën e vështirë të organizimit të ushtrisë shqiptare. Me përvojën 40-vjeçare në drejtimin dhe komandimin e ushtrisë, ai organizoi Komandën e Përgjithshme dhe Shtabin Madhor me strukturat përkatëse. Në sajë të aftësive të tij akademike kontribuoi në hartimin e “Rregullores për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës”, në hartimin e “Rregullores së përkohshme mbi formimin e strukturës së Milicisë Shqiptare” dhe mori masat e duhura për ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike. Pothuajse të gjithë ushtarakët e asaj kohe vinin nga shkolla ushtarake dhe nga radhët e ushtrisë turke. Madje edhe Mehmet Pashë Deralla më 1878, kur ishte në moshën 35-vjeçare, fitoi titullin e “Pashait”, që nënkuptonte atë të gjeneralit. Titullin e “Pashait” ai e mori pas studimeve në Akademinë Ushtarake të Stambollit dhe në shkollën e lartë të Shtatmadhorisë në Stamboll, që ishte niveli më i lartë i arsimit

ushtarak në Turqi. Gjeneral Deralla me mbështetjen e oficerëve të përkushtuar si Ali Shefqeti, Mustafa Aranitasi, Kasem Qafëzezi, Ali Tetova etj., hodhi bazat e ushtrisë shqiptare, e cila në atë kohë përbëhej nga 70 oficerë, 155 kapterë dhe rreth 5000 ushtarë vullnetarë. Në krye të Shtatmadhorisë së parë shqiptare u zgjodh Ali Shefqeti.

Mehmet Pashë Deralla ka hyrë në memorien historike të shqiptarëve si gjenerali shtatlartë, që qëndronte në ballkon në krah të Ismail Qemalit, në përvjetorin e parë të ngritjes së flamurit më 1913. Populli e ka përjetësuar në vargjet: “Mehmet Pashë Deralla, /Rritur me përshesh baruti, /Të kishte shku fjala dhe palla, /Lisit i je te supi....”

Për dy vjet Mehmet Pashë Deralla kreu me përkushtim detyrën e ministrit të Luftës në Qeverinë e Përkohshme të Vlorës. Pas janarit të vitit 1914, qeveria e Ismail Qemalit dha dorëheqjen, ndërkohë qeveria e Princit Vilhelm fon Vid caktoi në detyrën e ministrit të Luftës, Esat Pashë Toptanin. Pasi u largua nga detyra e ministrit, Mehmet Pashë Deralla ka marrë pjesë në organizimin dhe drejtimin e kryengritjeve kundër shovinistëve serbë. Më 1916, ai u kap dhe u burgos në Podgoricë. Pasi doli nga burgu u vendos në qytetin e Shkodrës. Mehmet Pashë Deralla vdiq i helmuar, në vitin 1918.

Një pinjoll i shquar i familjes Deralla ka qenë Halim bej Deralla (1879-1934), i biri i Mehmet Pashë Derallës. Halimi ka lindur më 1879 në Gradec të Tetovës. Studimet e larta i kreu në Stamboll, ku u diplomua për drejtësi. Me përfundimin e studimeve, ai u emërua zyrtar i lartë i administratës osmane. Në vitin 1910, Halim Deralla, së bashku me babanë e tij, Mehmetin, kanë marrë pjesë në Kuvendin e Gjilanit, ku përkrahën Kryengritjen e Kaçanikut dhe udhëheqësin e saj, Idriz Seferin. Gjithashtu, Halim Deralla ka marrë pjesë në Kuvendin e Junikut dhe në çlirimin e Shkupit më 1912. Ai ka qenë në krye të luftëtarëve tetovarë, për të përballuar sulmet turke dhe ato serbo-bullgare. Në vjeshtën e vitit 1914, atë e arrestuan dhe e dërguan në Karllövë të Bullgarisë. Pasi u arratis nga burgu, doli me luftëtarët në malet e Sharrit. Në vitin 1921,

kur u konstituua Parlamenti, Halim Deralla u zgjodh deputet i trevave shqiptare të Maqedonisë. Gjatë viteve që ka qenë deputet në parlament, ai ishte një zë i fuqishëm për mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve. Në vitet 1930-1931, Halim Derallës iu bënë dy atentate nga qarqet shoviniste serbe. Ky ishte shkaku që ai u detyrua të largohet nga Tetova, për t'u vendosur në Tiranë. Halim Deralla vdiq në mënyrë të mistershme, në vitin 1934, në Tiranë. Kalvari i persekutimit të familjes Deralla vijoi me Gajur Derallën, ushtarak i zoti, të cilin e vranë partizanët e pasluftës.

Në vitin 2012, Presidenti i Republikës, z. Bujar Nishani, në kuadër të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dekretoi me urdhrin "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", birin e Tetovës, Mehmet Pashë Derallën (pas vdekjes), me motivacionin: "Për rolin e tij historik në krijimin dhe shpalljen e shtetit të lirë e të pavarur shqiptar. Për meritat e tij si figurë e shquar e kombit shqiptar, me kontribut madhor, si një ndër protagonistët e Lidhjes së Prizrenit dhe si organizator e frymëzues i qëndresës me armë në dorë kundër të gjitha trupave pushtuese ballkanike". Sigurisht që ky është vlerësimi më i pakët për njeriun që sakrifikoi kaq shumë për çështjen kombëtare shqiptare. Sot e kësaj dite, ai që flaku tutje medaljet e sulltanit dhe përqafoi idetë e shqiptarizmit, është pa varr. Eshtrat e patriotit të madh Mehmet Pashë Deralla meritojnë respekt dhe dashuri.

## **Përfundim**

Mehmet Pashë Deralla ka hyrë në histori si ministri i parë i Luftës së Shtetit Shqiptar. Për nder të tij, 4 Dhjetori është caktuar Festa e Kombëtare e Forcave të Armatosura Shqiptare. Më 4 dhjetor të vitit 2009, në përvjetorin e 97-të të Forcave të Armatosura Shqiptare, Ministria e Mbrojtjes e dekoroi Mehmet Pashë Derallën me medaljen “Për shërbime të shquara”. Ndërsa më 28 nëntor 2011, në sheshin që mban emrin e tij në Gradec, u përrua busti i patriotit dhe atdhetarit, Mehmet Pashë Deralla. Gjithashtu, shkolla e Gradecit mban emrin “Mehmet Deralla”.

**(kumtesë e lexuar me rastin e përvjetorit, botohet si e tillë)**

## **Bibliografia**

1-Arsim Sinani, Neoshqiptarizmi i Mehmet Pashë Derallës, Revista Shkencore Ndërkombëtare Diskutime, Nr. 11, maj 2014, faqe 3-4.

2-Edwin E. Jacques, Shqiptarët. Populli shqiptar nga lashtësia deri në vitin 1912, Kartë e Pendë, Tiranë 1995.

3-Ilir Ikonimi, Pavarësia, udhëtimi i paharruar i Ismail Qemalit, UET Press, Tiranë 2012, faqe 278-279.

4-Ismail Arslani, Me Ismail Qemalin ishte Mehmet Pashë Deralla, Revista Shkencore Ndërkombëtare Diskutime, Nr. 11, maj 2014, faqe 22-34.5-Historia e Popullit Shqiptar, vol. II, Akademia e Shkencave, Toena, Tiranë 2002.

6-Kristo Frashëri, Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, botim i Akademisë së Shkencave të RPS të Shqipërisë, Tiranë 1989.

7-Lidhja e Prizrenit në dokumente osmane, botim i Arkivit të Kosovës, Prishtinë 1978.

8-Proletar Hasani, Edit Bregu, Plejada e oficerëve shqiptarë të shkollës ushtarake turke, gjeneral brigade Mehmet Pashë Deralla (Tetova), Revista Shkencore Ndërkombëtare Diskutime, Nr. 11, maj 2014, faqe 16-21.9-Qeveria e përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj, Nëntor 1912-Janar 1914, botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të R.P.Sh., Tiranë 1963, faqe 58-59.

10-Robert Mantranit, Historia e Perandorisë Osmane, Dituria, Tiranë 2004.

11-Vangjel Kasapi, Mehmet Pashë Deralla, Tiranë 1995.

12-Zaho Golemi, Aurora Golemi, Themelimi i Ministrisë së Luftës dhe fryma e re kombëtare shqiptare (Mehmet Pashë Deralla), Revista Shkencore Ndërkombëtare Diskutime, Nr. 11, maj 2014, faqe 7-15.